



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikë së Maqedonisë së Veriut" numër 12/19), dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit duke vepruar për lëndën e formuar pas denoncimit nga pesoni anonim (paraqitje anonime), në vazhdimin e seancës së 42-të të mbajtur me datë 11.12.2020, e morri këtë

VENDIM

Procedura për lëndën me numër 12-3191/1 me datë 19.06.2019 e formuar pas denoncimit anonime të dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm në lëndën me numër 12-3191/1 me datë 19.06.2019.

Lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK, me sqarimin, në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e KSHPK në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e vendimmarrjes.

SQARIM

Lënda me numër 12-3191/1 me datë 19.06.2019 është formuar mbi bazë të denoncimit anonime.

Në denoncim bëhet fjalë për akuza me dyshime në vendimmarrjen joligjore në Vendimin e administratë së Fakultetit Filozofik për vazhdimin e periudhës për përgaditje të disertacionit të doktoraturës të doktorantëve të regjistruar në vitin 2011 me status të shuar të doktoraturës me participim financiar prej 30.000,00 denarë. Në denoncim theksohet se në procedurë jotransparente në kundrshtim të nenit 54 nga Rregullorja për kushtet, kriteret dhe rregullat për studim në ciklin e tretë të studimeve – studime doktorature (Shkurt 2010) gjatë vitit 2019, veçanërisht në muajin maj dhe qershor më shumë doktorantëve me shumë të caktuar financiare iu vazhdua njëherë ose dyherë statusi i doktorantit. Në denoncim theksohet se në Fakultetin Filozofik janë ndërmarrë veprime kundërligjore për kompenzim financiar edhe për vazhdimin e afatit për përgaditjen e temës së magjistraturës të kandidatëve me tema të miratuara ndërmjet viteve 2013-2015, të cilët sipas Rregullores adekuate, kanë humbur të drejtën për mbrojtje të temës së paraqitur.

Me qëllim të kontrollimit të formulimit të akuzave në denoncim dhe caktimin e gjendjes faktike në rastin konkret, KSHPK dërgoi Kërkesë për mbledhje të të dhënave dhe informacioneve me numër 12-239/1 me datë 03.09.2020 deri tek Inspektorati shtetëror i arsmit (ISHA) me të cilën kërkon të dorëzohen informacione për ato se vallë Inspektorati veprroi pas Ankesës së dorëzuar (duke pasë informacione se e njëjta ankesë ishte dorëzuar edhe deri tek Inspektorati), gjegjësisht a ka bërë inspektim të jashtëzakonshëm për aplikimin e Rregullores për kushtet, kriteret dhe rregullat e studimit në ciklin e tretë studimor – studime doktorature (Shkurt 2010) në lidhje me statusin e doktorantit, si dhe për personat të cilëve iu është vazhduar statusi i magjistrantit pas viti 2015 dhe cili është përfundimi nga veprimi.

Nga Inspektorati shtetëror i arsimit sipas kohës së caktuar me ligj u dorëzua përgjigje për kërkesën e KSHPK. Në lidhje me akuzat se e njëjta është parashtruar edhe deri tek Inspektorati shtetëror i arsimit, Inspektorati e informoi KSHPK se në Arkivën e ISHA nuk është parashtruar fjetëparaqitje për këto akuza.

Pa rishikimit të akuzave në denoncim dhe të dhënave të mbledhura nga institucionet tjera kompetente, KSHPK e vërtetoi këtë:

Administrata e Dekanit të Fakultetit Filozofik në seancën e 26-të të mbajtur me datë 10.04.2019 morri Vendim me numër 02-1186/5 me datë 11.04.2019 për vazhdimin e afatit për punimin e temës së doktoraturës të doktorantëve të regjistruar në studime doktorature – sistemi me mentor, me të cilën të gjithë doktorantëve të cilët kan paraqitur temë për punimin e doktoraturës deri me datë 31.12.2011 në studimet e doktoraturës – sistemi me mentor, dhe në të cilën iu është përfunduar afati i dorëzimit të punimit të doktoraturës mund t’iu vazhdohet më së shumë 1 (një) vit. Pas përfundimit të atij afati, kandidatët nuk kanë të drejtë të dorëzojnë kërkesë për vazhdim të afatit për punim të doktoraturës dhe e humbin të drejtën që ta mbrojnë punimin. Për vazhdimin e afatit për punimin e temës së doktoraturës doktorantët janë të obliguar që të bëjnë pagesën në përputhje me Çmimoren për lartësinë e shpenzimeve për shërbimet e realizuara arsimore dhe administrative.

Gjatë inspektimit nga ana e Inspektoratit shtetëror të arsimit në evidencën e kandidatëve të cilët kanë paraqitur dhe mbrojtur disertacionin e doktoraturës në vitin 2011 gjithsej janë të evidentuar 147 kandidatë, prej tyre:

- 88 kandidat kan mbrojtur disertacionin e doktoraturës (dhe atë 66 në kohën e paraparë me ligj kurse 22 kandidatë me vazhdimin e afatit për përgaditjen e punimit në përputhje me nenin 54 paragrafi 2 nga Rregullorja për bazë të vetme për organizimin e studimeve post-diplomike dhe studime të doktoraturës (Zëri i Universitetit numër 7/2001),
- 5 kandidatë e vazhduan afatin e tyre për përgaditjen e punimit në përputhje me nenin 54 paragrafi 2 të Rregullores të cituar më lartë (nga ato 2 kandidat janë në procedurë të mbrojtjes, kurse 3 kandidatë nuk kanë dorëzuar punim të doktoraturës dhe kan humbur të drejtën e mbrojtjes së temës së paraqitur, gjegjësisht të pranuar për punimin e e disertacionit të doktoraturës në përputhje me nenin 54 paragrafi 3 nga Rregullorja), dhe
- 52 kandidat nuk kan zgjedhur disertacion të doktoraturës në afatin e caktuar ligjor nga dita e miratimit të temës për disertacionin e doktoraturës (respektivisht 5 kandidat e vazhduan afatin për punimin e punës, por nuk dorëzuan punim të punuar dhe e humbën të drejtën për mbrojtje të temë së paraqitur gjegjësisht të pranuar të disertacionit të doktoraturës në përputhje me nenin 54 paragrafi 2 dhe 3 nga Rregullorja, 47 kandidatët tjerë nga dita e miratimit të temës për disertacionin e doktoraturës as kanë zgjedhur as kan kërkuar vazhdim të afatit për punim të punës).

Në përputhje me Vendimin e administratës së Dekanatit të Fakultetit Filozofik – Shkup, me Lajmërim për punimin e distertacionit të doktoraturës nga ana e Dekanit të Fakultetit Filozofik - Shkup, janë të informuar në punimin e doktoraturë derin me datë 31.12.2011), kurse iu është ndryshuar afati i përgaditjes, të dorëzojnë Kërkesë për vazhdim të afatit më së voni deri me 30.05.2019. Nga gjithsej 52 kandidatë të cilëve iu kaloi afati për paraqitjen e punimit të doktoraturës në përputhje me Vendimin e marrë, kërkesë për vazhdimin dorëzuan vetëm 6 kandidatë dhe nga ato një kandidat e mbrojtë disertacionin e doktoraturës, kurse 5 kandidaët tjerë nuk dorëzuan punim të punuar të doktoraturës dhe e humbën të drejtën për mbrojtje të temës së paraqitur, respektivisht të pranuar për përgaditje të punimit të doktoraturës.

Në bazë të Vendimit numër 02-1166/5 me datë 11.04.2019 për vazhdimin e afatit për përgaditje të punimit të doktoraturës të regjistrua në studimet e doktoraturës – sistemi me mentor, Këshilli arsimor-shkencor i Fakultetit Filozofik në Shkup në senacën e mbajtur me datë 09.10.2019, morri Vendim me numër 02-2393/8 me datë 18.10.2020 për humbje të të drejtës për mbrojtje të temës së pranuar për përgaditje të disertacionit të doktoraturës në studimet e doktoraturës (sistemi me mentor), me të cilën doktorantët të cilët kanë paraqitur temën e studimeve të doktoraturës – sistemi me mentor të cilëve iu ka kaluar afati për dorëzimin e punimit të doktoraturës, as që kanë kërkuar vazhdimin e afatit për shkaqe të arsyeshme dhe të cilët në përputhje me vendimin nuk dorëzuan kërkesë për vazhdim e përgaditjes së punimit të doktoraturës e humbin të drejtën për mbrojtje të temës së pranuar për përgaditje të disertacionit të doktoraturës. Në përputhje me këtë vendim gjithsej 54 kandidat e kanë humbur të drejtën për mbrojtje të temës së paraqitur për përgaditje të disertacionit të doktoraturës.

Në bazë të nenit 75 nga statusi i Fakultetit Filozofik në Shkup (Zëri i Universitetit numër 463 me datë 18.10.2019) dhe Rregullorja për kushtet, kriteret dhe rregullat për regjistrim dhe studime në ciklin e parë të studimeve (studime deri-diplomike) dhe ciklin e dytë të studimeve (studime post-diplomike) në Universitetin "Shën Qirili dhe Metodij" në Shkup (Zëri i Universitetit numër 417 me datë 29.01.2019), si dhe neni 120 nga Ligji për arsim të lartë (Gazeta zyrtare e RM numër 82/2018), Administrata e Dekanatit të Fakultetit Filozofik në Shkup në senacën e rregullt të 38-të të mbajtur me datë 11.11.2019, morri Vendim me numër 02-2907 me datë 13.11.2019 për caktim të kushteve për vazhdimin të afatit për përgaditje të punimit të magjistraturës në ciklin e dytë të studimeve të cilët kanë temë të miratuara dhe mentor për përgaditje e punimit të magjistraturës, por që iu ka mbaruar afati për përgaditjen e saj, iu miratohet vazhdimi i afatit për përgaditjen e temës së magjistraturës në bazë të kërkesës paraprake për vazhdim të afatit me sqarim.

Nga inspektimi në evidencën në rishikim të temave të miratuara të kandidatëve për përgaditje të punimit të magjistraturës në periudhën prej 2013 deri 2015, gjithsej janë evituar 513 tema të miratara, prej tyre:

- 479 kandidat kanë mbrojtur punimin e magjistraturës së përgaditur në afatin e paraprakë me ligj nga dita e miratimit të temës së punimit të magjistraturës.
- 34 kandidat kanë kërkuar vazhdim të afatit për përgaditje të punimit të magjistraturës, në përputhje me nenin 230 paragrafi 3 nga Statusi i Universitetit "Shën Qirili dhe Metodij" – Shkup, prej tyre
 - o 21 kandidat kanë mbrojtur punimin e përgaditur të magjistraturës, pas vazhdimit të afatit
 - o 4 kandidat pas vazhdimit të afatit janë në procedurë,
 - o 7 kandidat pas vazhdimit të afatit nuk dorëzuan punim të përgaditur të magjistraturës dhe e humbën të drejtën për ta mbrojtur punimin e paraqitur të magjistraturës në përputhje me nenin 230 paragrafi 3 nga Statusi,
 - o Një kandidat ka recension negativ, dhe
 - o Një kandidat është me vendim për pushim të statusit (përshkak të shtatzanisë patologjike)

Nga numri i përgjithshëm i kandidatëve me tema të miratuara të magjistraturës në periudhën prej 2013 deri 2015, në përputhje me Vendimin e marrë, kërkesë për vazhdimin e afatit për përgaditje të punimit të magjistraturës dorëzuan vetëm 19 kandidat, prej tyre 11 e mbrojtën punimin e përgaditur të magjistraturës, kurse 8 kandidat e humbën të drejtën që ta mbrojnë punimin e përgaditur të magjistraturës.

Dekani i Fakultetit Filozofik në Shkup, në lidhje me Kërkesën, dorëzoi Deklaratë me numër 03-1725/1 me datë 29.09.2020 deri tek Inspektorati shtetëror i arsimit, në të cilën në lidhje me akuzat për vazhdimin e

periudhës për përgaditje të punimit të doktoraturës të doktorantëve të regjistruar në viti 2011 me status të shuar të doktorantit me participim financiar prej 30.000 denar, u shpreh se "Studimet e doktoraturës sipas sistemit të vjetër (sistemi me mentor) organizohen mbi bazë të Rregullores së vjetër për bazë të vetme për organizim të studimeve post-diplomike dhe studime të doktoraturës (Zëri i Universitetit nr. 7/2001)". Në përputhje me nenin 54 paragrafi 2 nga kjo Rregullore në kërkesë të kandidatëve me shkaqe të arshyeshme Këshilli arsimor-shkencor mund t'iu vazhdon afatin për përgaditje të punimit për kohën derisa ekzistojnë shkaqet për pengesë të përgaditjes së temës.

Zbrastira ligjore për këto studime të organizuara sipas sistemit të vjetër me mentor është e patheksuar në Rregulloren për bazë të vetme për organizimin e studimeve post-diplomike dhe të doktoraturës (Zëri i Universitetit nr. 7/2001) me çka në paragrafin 2 nga neni 54 iu jep mundësi studentit që t'iu vazhdon studimet duke mos u theksuar koha deri kur mund të vazhdon mundësia dhe sa herë e ka si mundësi. Në mënyrë plotësuese dhe Ligji i vjetër për arsimit të lartë nga viti 2008 si dhe Ligji për arsim të lartë nga viti 2000 i cili i rregullon të gjitha çështjet e statusit të studentit është i patheksuar në atë pjesë, gjegjësisht udhëzon që kjo çështje të precizohet më mirë me Statusin e Universitetit, gjegjësisht të Fakultetit. Analizimi i Statusit të Universitetit nga viti 2008 dhe 2000 tregon në problemin për mungesën e kornizës kohore për kohëzgjatje të studimeve gjë që paraqet problem shtesë.

Në përputhje me të theksuarën Administrata e Dekanatit të Fakultetit Filozofik në senacën e rregullt të 26-të të mbajtur me datë 10.04.2019 morri Vendim për vazhdimin e afatit për përgaditje të punimit të doktoraturës të doktorantëve të regjistruar në studimet e doktoraturës – sistemi me mentor.

Për vazhdimin e afatit për përgaditje e punimit të doktoraturës doktorantët janë të obliguar të bëjnë pagesën në përputhje me Çmimoren për lartësinë e shpenzimeve për realizimin e shërbimeve arsimore dhe administrative.

Me hyrjen në fuqi të Rregullores së re për kushtet, kriteret, rregullat dhe procedura për regjistrim dhe studim në ciklin e parë të studimeve (studime deri-diplomike), dhe ciklin e dytë (studime post-diplomike) në Universitetin "Shën Qirili dhe Metodij" në Shkup (Zëri i Universitetit nr. 417/2019) mbaruan të vlejné rregullat sipas Rregullores së vjetër, kurse studentët të regjistruar deri në hyrjen në fuqi të Rregullores së re, vazhdojn të studiojnë sipas rregullave të caktuara me programën studimore dhe rregullat kësaj Rregulorje nesë janë më të favorshme për ato (neni 101). Nga këtu, Fakulteti gjatë marrjes së Vendimit për caktimin e kushteve për vazhdimin e afatit për përgaditje të punimit të magjistraturës, është parë sipas udhëzimeve që janë më të favorshme për studentët, veçanërisht në situatë në të cilën afati i akreditimit të programës së vjetër studimore në ciklin e dytë ka mbaruar dhe nuk ishte i lejuar regjistrimi i studentëve të ri në vitin akademik 2019/20, ishte i pavolitshëm për studentët dhe në kundërshtim me nenin 101 që nënkupton se studentët që të vazhdojnë me studimin është e nevojshme që t'iu bëhet ekuivalencë dhe varësisht nga dallimet sipas lëndëve që do të paraqiteshin në mes të programës së vjetër dhe të programës së re studimore Do të duhet të ri-hyjn në provime në lëndët eventuale të reja. Në lidhje me lartësinë e shpenzimeve për shërbimet e realizuara arsimor dhe administrative, si në të gjitha Fakultetet e Universitetit, ashtu edhe në Fakultetin Filozofik, në rastin e ciklit të dytë të studimeve është caktuar sipas çmimoreve adekuate, kurse për këtë lloj të shërbimeve çmimi është i pandryshuar në 15 vitet e fundit.

Në përputhje me inspektimin e lartpërmendur të dokumentacionit për ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve në Fakultetin Filozofik – Universiteti "Shën Qirili dhe Metodij" në Shkup, kurse në lidhje me vendimet e marrura për vazhdimin e afatit për përgaditje e disertacionit të doktoraturës të kandidatëve të regjistruar në vitin 2001, vazhdimi i afatit për përgaditjen e punimit ë magjistraturës të kandidatëve me tema të miratuara në periudhën prej 2013 deri 2015, si dhe për rregullativën e paraparë për aktet ligjore dhe nën-ligjore të Universitetit dhe Njësisë në kuadër të Universitetit, Inspektorati shtetëror i arsimit nuk pati mundësi të konstatojë parregullsi në vendimet e marrura nga shkaqe formulimi i theksuar në rregulloret e rregullativave ligjore nuk jep shprehje të qartë në lidhje me vazhdimin e afatit për mbrojtje pa precizime konkrete se cilët janë ato kufizime të caktuara me ligj, gjegjësisht ato normativa të jenë në përputhje me qëllimet që duhen të arrihen me të njëjtat. Inspektorati shtetëror i arsimit në rastin konkret i ka parasysh edhe nenin 7, 8 dhe 9 nga Ligji për arsim të lartë (Gazeta zyrtare e RM nr. 82/2018), në të cilën shprehet autonomia e institucioneve të larta arsimore, e cila autonomi është e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, KSHPK konstatojë se në rastin konkret nuk ekziston mundësi për vërtetimin e parregullsive të bëra në vendimet e marrura nga Këshilli arsimor-shkencor i Fakultetit Filozofik në Universitetin "Shën Qirili dhe Metodij" në Shkup, nga arsye që në rregullativat ligjore pozitive ekziston vakum ligjor gjegjësisht të patheksuara në lidhje me qështjen e vazhimit të afatit për mbrojtje të punimeve të doktoraturës dhe të magjistraturës pas precizime konkrete se cilët janë ato përkufizime të caktuara me ligj. Nga këtu, KSHPK përfundon se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm në lëndën në fjalë dhe lënda të mbyllet dhe të arkivohet. Duke pasë parasysh të theksuarën më lartë, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi në bazë të dispozitave të këtij vendimi.

Punoi: M-r I. P.

Miratoi: N. B. Anëtar i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËROR PËR
PARANDALIM TË
KORRUPSIONIT
Kryetarë: Biljana Ivanovska**